

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Pogradec

Keshilli i Bashkisë Pogradec

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqëqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural,

Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes së Mire, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikës, Konfliktit të Interesit, Standarteve dhe Apelimeve, Komisioni I Shërbimeve Publike, Transportit, Levizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapësinor, Infrastruktura dhe Strehimit

Raport vendimmarrjeje

Nr 6 /Datë 22.05 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin për “MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADEÇIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.05.2025

Analiza ligjore:

Projekt – vendimi u hartua në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 55 pikat 2 dhe 6, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 156, datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, në nenet 12, 41 dhe 85 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar, VKB-së nr. 24, datë 27.03.2025 “Për miratimin e tavanëve përgatitore buxhetore për Vitet 2026-2028”, VKB-së nr. 141, datë 27.12.2024 “Për miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për Vitin 2025”, si dhe referuar Kërkesës me nr. 4968 Prot, datë 06.12.2024, me lëndë “Kërkesë për marrje angazhimi për: “Pastrim, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative” të paraqitur nga Sektori i Supervizimit të Shërbimeve pranë Drejtorisë së Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit i tokës bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Situata aktuale e funksionit:

Bashkia Pogradec, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, në mbështetje të nenit 23, pika 10 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ku cilësohet se: Bashkitë ndër të tjera janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake”.

Duke qene se kontrata e shërbimit të pastrimit, përfundon në Muajin Gusht 2025, si rrjedhojë bëhet i domosdoshëm planifikimi i mirëfilltë i shërbimit të pastrimit për periudhën në vazhdim.

Bashkangjitur relacionit, materiale:

- 1.Preventivë Përmbledhës për Qytetin Pogradec dhe Njësitë Administrative
- 2.Specifikime teknike
3. Harta për vendosjen e kontenierëve
- 4.Harta për fshirjen e rrugëve
5. Harta për lagjen e rrugëve dhe larjen e shesheve
6. Harta për pastrimin e thelluar të lumenjve
7. Harta për mirëmbajtjen e rrugëve ditën.

Situata financiare:

Situata financiare dhe te dhena me te detajuara eshte paraqitur ne relacionin dhe tabelat shoqeruese te tij

Drejtoria/Spektori përgjegjës:

*Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve
Drejtoria e ekonomise dhe e menaxhimit financiar.*

Monitorimi dhe raportimi:

*Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve
Drejtoria e ekonomise dhe e menaxhimit financiar.
Keshilli bashkiak Pogradec*

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetaret e bashkise Pogradec

Perfaqesues nga; Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise, Mbiqyrjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural,

Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes se Mire, Administrates, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikes, Konflitet te Interesit, Standarteve dhe Apelimeve, Komisioni I Sherbimeve Publike, Transportit, Levizshemrise Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacioit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapesinor, Infrastruktures dhe Strehimit

mbledhur më datë 27.05 2025, shqyrtuan projektvendimin për "MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: "PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADEÇIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE", shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Gelmuk. Harthellau; Klea Topa

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i komisionit



Brunilda Gera; Kumroza Shuli

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i komisionit

Datë: 27.05 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Pogradec

Keshilli i Bashkisë Pogradec

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, i Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural,

Komisioni i Mireqenies Sociale

Raport vendimarrjeje

Nr 6 /Datë 22.05 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin “PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN Prill 2025” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së keshillit bashkiak, datë 29.05.2025

Analiza ligjore:

Projekt-vendimi u hartua në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.3 datë 27.01.2025, “Për miratimin e kriterëve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”:

Situata aktuale e funksionit:

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera nga administratorët shoqërorë të njësisë përkatse, ekzekutivi propozon të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin **PRILL 2025** gjithsej **177** familje me fond **730111** lek. (sipas tabelës së paraqitur në p-vendim)

Familjet në nevojë që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë të ndihmës ekonomike, janë përzgjedhur nga lista e familjeve që kanë aplikuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë shpallur përfutues nga sistemi i pikëzimit. Kjo listë del në fund të muajit. Administratorët shoqërorë kanë kryer paraprakisht vlerësimin social-ekonomik dhe kanë përzgjedhur familjet që plotësojnë kriteret për tu trajtuar nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike.

Situata financiare:

Situata financiare dhe te dhena me te detajuara eshte paraqitur ne relacionin dhe tabelat shoqeruese te tij. Per muajin prill 2025 do te trajtohen me ndihme ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike gjithsej 177 familje me fond 730111 lek.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e shërbimeve sociale, bashkia Pogradec

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e shërbimeve sociale, bashkia Pogradec

Drejtoria e ekonomisë dhe e menaxhimit financiar.

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Qytetaret e shtresave në nevojë në bashkinë Pogradec

Perfaqesues nga; Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbrojtjes Financiare, të Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural, Komisioni i mirëqenies sociale; mbledhur më datë _____ 2025, shqyrtuan projektvendimin për “PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN Prill 2025”, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

a- (Miratimin e projektaktit.

b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.

c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.

d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Gelmir Hashellari
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i komisionit



Baumilda Gora
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i komisionit

Datë: _____ 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Pogradec

Keshilli i Bashkisë Pogradec

Raport vendimmarrije

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit, Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit

Nr 8 /Datë 22.052025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin për “PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QERASË PËR ZNJ. TEUTA ÇELA NË BASHKINË POGRADEC” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.05.2025

Analiza ligjore:

Projekt – vendimi u hartua Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24 pika 1, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 3, pika 3, nenit 15, pika 5, nenit 33, pika 1, neni 34 pika 3 germa g, të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe bazuar në procesverbalin e komisionit të strehimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

Situata aktuale e funksionit:

Në vijim të Aplikimit në shërbimin elektronik e-albania konkretisht rubrika “Kërkesë për të Përfutur nga Programet e Strehimit Social” së Znj. Teuta Çela në date 21.05.2025, u përgatit dokumentacioni i duhur për të përfutur “Subvencionimi Qerasë” pasi u evidentua gjëndja e banimit, gjëndja sociale dhe ekonomike.

Aplikuesja është nënë e divorcuar me tre fëmijë. Trajtohet me ndihmë ekonomike dhe është anëtare e komitetit egjiptian.

Në bazë të kushteve të vështira ekonomike, sociale dhe jetesës, zyra e strehimit kërkon shtyrjen e afatit të subvencionimit të bonusit të qerasë edhe për 12 muaj, pasi qytetarit në fjalë akoma nuk i është gjetur një strehim përfundimtar. Bashkangjitur relacionit, është lista me dokumentat e plotësuar konform akteve ligjore e nenligjore.

Situata financiare:

Efektet financiare në shumën 120.000 (Njëqind e njëzetmijë) lekë, do të mbulohen nga Fondi Rezervë i Bashkisë Pogradec.

Pagesa e qirasë do të kryhet në bazë të paraqitjes së kontratave të qirasë dhe kushteve të strehimit që parashikohen në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, pranë Drejtorisë së Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

*Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve
Drejtoria e ekonomisë dhe e menaxhimit financiar.*

Monitorimi dhe raportimi:

*Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve
Drejtoria e ekonomisë dhe e menaxhimit financiar.
Keshilli bashkiak Pogradec*

Impakti social/grupet që preken:

Qytetaret e bashkisë Pogradec

Perfaqesues nga; Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit, Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit; mbledhur më datë _____ 2025, shqyrtuan projektvendimin për "PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QERASË PËR ZNJ. TEUTA ÇELA NË BASHKINË POGRADEK" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Ahmed Gjusholl.  Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Vjella Pellaha Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 27.05. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Pogradec

Keshilli i Bashkisë Pogradec

Komisioni I Sherbimeve Publike, Transportit, Levizshemrise Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacioit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapesinor, Infrastruktures dhe Strehimit

Raport vendimarrjeje

Nr 9 /Datë 29.05 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin "PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR SHESH PËR DEPOZITIMIN E PËRKOSSHËM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKA TRANSITI), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.05.2025.

Analiza ligjore:

Projekt – vendimi u hartua në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave, Nr.559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,,

Situata aktuale e funksionit:

Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin.

Për sa më sipër, Sektori i Trajtimit të Titujve të Pronësisë dhe Shpronësimeve, Bashkia Pogradec, ka marrë evidentuar pronen me nr 34 Zk 1208 qe mund te jete nje prone qe mund te zhvillohet nga individe te ndryshem per qellimin e cituar me lart, për vete pozicionimin dhe

vendosjen e kesaj prone mabsi eshte larg nga qendrat e banuar dhe pa ndikime ne mjedis. Nga analiza dhe interesimi i disa individeve dhe pozicjonin e pasurise propozojme dhenien me qera te siperfaqes prej 4 ha siperfaqe e cila sipas llojit te qeverisjes se pyjeve sipas planit te mbareshtimit te ish komunes Cerrave eshte inproduktive ne vendin e quajtur Blace. Siperfaqia e kerkuar ndodhet , ne kufirin ndermjet Fshatrave Cerrave dhe Blace ne nje largesi te konsiderueshme nga qendrat e banuara, dhe tradicionalisht ka qene pjese e fshatit Çërravë pavaresisht se ne zone kadastrale eshte ne fshatin Blacë

Ne referim te baze ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Pikes 5, shkronja "dh", Kreu I, Pikes 6, shkronja "b", germa "i" , Kreu II, të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "12", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

Gjithashtu, kontrata bashkengjitur projekt vendimit, eshte hartuar ne zbatim te Vendimit Nr. 421, datë 12.6.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Perfundimisht, per sa me siper, Në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12 2014 "Për veteqeverisjen vendore", citohet se: "Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve". Mbasi edhe konsultimi publik me pjesemarrjen e keshilltareve eshte realizuar.

Situata financiare:

Situata financiare dhe te dhena me te detajuara ne relacionin bashkelidhur p-vendimit.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve; Sektori I trajtimit te titujve te pronesise dhe shpronesimeve.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve

Drejtoria e ekonomise dhe e menaxhimit financiar.

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetaret e bashkise Pogradec

Perfaqesues nga;

Komisioni I Sherbimeve Publike, Transportit, Levizshemrise Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacioit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapesinor, Infrastruktures dhe Strehimit

mbledhur më datë 27.05 2025, shqyrtuan projektvendimin për "PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIËS ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDIVE KËRKUES PËR SHESH PËR DEPOZITIMIN E PËRKOSSHËM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKA TRANSITI), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2", shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Ahmed Guxholli Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Vjollca Pellaha Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 27.05 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Pogradec

Keshilli i Bashkisë Pogradec

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqëqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural,

Raport vendimarrjeje

Nr 7 /Datë 22.05 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin për “MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 TË BASHKISË POGRADEK (Faza I)” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së keshillit bashkiak, datë 29.05.2025

Analiza ligjore:

Projekt – vendimi u hartua në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b” dhe nënpika 1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 41, pika 1 dhe pika 2 shkronja “d”, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar, nenit 36 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 16.05.2024, “Për një shtesë në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar”, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV” të ndryshuar, Udhëzim Nr.8 datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028” me shtojcat plotësuese, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec,

Situata aktuale e funksionit:

Në zbatim të udhëzimit nr 8, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave, Njësia e Vetëqeverisjes Vendore ka përfunduar Fazën e Parë të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për periudhën 2026-2028, e cila përfaqëson fazën strategjike të këtij procesi. Kjo fazë është fokusuar në identifikimin e prioriteteve të zhvillimit, vlerësimin e politikave ekzistuese dhe hartimin e propozimeve për politika të reja, të cilat përputhen me objektivat afatgjata të njësisë dhe nevojat e komunitetit.

Gjatë kësaj faze janë hartuar Deklaratat e Politikave të Programit (DPP) dhe Planetet e shpenzimeve të Programeve (PSHP), si për politikat ekzistuese dhe ato të reja në përputhje me tavanet orientuese të përcaktuara për çdo program. Procesi është zhvilluar në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS).

Faza e Parë e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit.

Dokumentacioni përkatës i Fazës së Parë të PBA-së është përgatitur sipas formateve standarte të Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe do të dërgohet pranë Ministrisë së Financave deri më datë 1 qershor ,në përputhje me afatet ligjore.

Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Situata financiare:

Situata financiare dhe te dhena me te detajuara eshte paraqitur ne tabelat shoqeruese te relacionit te ketij p-vendimi.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e ekonomise dhe e menaxhimit financiar.

GMS

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e ekonomise dhe e menaxhimit financiar.

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetaret e bashkise Pogradec

Perfaqesues nga; Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise,Mbikeqyrjes Financiare,I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural,

mbledhur më datë 27.05 2025, shqyrtuan projektvendimin per “MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË POGRADEK (Faza I)” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

a- *(Miratimin e projektaktit.*

b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*

c- *Refuzimin e miratimit te projektaktit.*

d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Celmir Haxhillari Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)



Baumilda Gora Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 27.05.2025 2025